

Çfarë duhet të bëjnë prindërit kur fëmija i tyre dygjuhësh duket se përballet me vështirësi gjuhësore?

- Disa, me vullnetin e mirë, mund t'u sygjerojnë prindërve se nuk duhet ta përdorin gjuhën e tyre amtare. Këshilla të tilla janë të gabuara.
- Në familjet eterogjene nëse njëri nga të dy prindërit nuk flet gjuhën tjetër, do të ishte mirë ta mësojë, duke i treguar kështu fëmijës se gjuha tjetër është e rëndësishme dhe ia vlen ta mësojë dhe ai/ajo.
- Kur fëmijët vështirësohen të shprehen, duhet të pyesim veten pse ndodh kjo:
 - Mos përpiqen të flasin më shpejt nga ç'e lejon niveli i zhvillimit të tyre gjuhësor?
 - Mos ndihen të presionuar të thonë diçka shpejt, sepse zakonisht ndërpriten nga të tjerët kur flasin?
 - Mos përballen me ndonjë vështirësi tjetër në jetën e tyre pamvarësisht nga gjuha?
 - Mos është çështje xhelozie me motrat e vëllezërit e tjerë apo me bashkëmoshatarët e tyre?

Çfarëdo që të jetë rasti, është e rëndësishme që dëgjuesi të mos tregojë pakënaqësi apo padurim kur fëmijët vështirësohen të shprehen.



Enti zbatues

POLIDHROMOS: Grupi dhe Botimi periodik për Dygjuhësinë dhe Shumëkulturën në Arsim dhe në Shoqëri



www.polydromo.gr
polydromo@polydromo.gr

Autore teksti
Rula Cokalidhu

Koordinatorë të programit
Birbili Maria – Cokalidhu Rula
Departamenti i Shkencave të Edukimit
dhe të Arsimit Parashkollor
Universiteti Aristoteli Selanik

Email: mmpirmpi@nured.auth.gr
tsokalid@nured.auth.gr

Website: www.polydromo.gr/dialogos

Përkthyes
Valbona Hystuna

Përpunuan tekstin
Evi Marku

Me mbështetjen e

Dygjuhësia dhe Arsimi

**Informohem
rreth arsimit**





Çfarë quajmë dygjuhësi?

Dygjuhësia është aftësia e prodhimit të fjalive të plota në dy apo më shumë gjuhë. Person dygjuhësh quhet ai/ajo që përdor dy (apo më shumë) gjuhë në jetën e tij të përditshme (p.sh. një gjuhë në shtëpi dhe një tjetër në shkollë, ose një gjuhë me nënën dhe një tjetër me babain).

Dygjuhësia e individëve që u përkasin dy apo më shumë komuniteteve gjuhësore shpesh krijon shqetësime ose dyshime tek njerëzit njëgjuhësh. Kjo mund të ndodhë sepse:

- Shpesh personat dygjuhësh i «përziejnë» të dyja gjuhët e tyre me qëllim të mbulojnë më mirë nevojat në komunikimin e tyre.
- Për personat dygjuhësh, nuk bashkekzistojnë vetëm dy (apo dhe më shumë) gjuhët, por edhe elementët e larmishëm kulturorë dhe këndvështrimet e ndryshme në të përditshmen e tyre.

Në shumë raste, termi 'dygjuhësi' përdoret si dhe termi 'shumëgjuhësi'

A ndihmon njohja e gjuhës së familjes, në mësimin e gjuhës së dytë, asaj të shkollës?

Sipas parimit të ndërvarësisë së gjuhëve:

- Gjuhët nuk mësohen si njësi të pavarura, por si marrëdhënie midis tyre: çfarë mësohet nëpërmjet njëres përdoret në njëfarë mënyre nëpërmjet tjetrës.
- Njohuritë që fëmijët sjellin nga shtëpia duhet të aktivizohen në shkollë dhe të pasurohen nëpërmjet njohurive të reja dhe gjuhës së shkollës.

Cummins, J. (2001) *Negotiating Identities: Education for Empowerment in a Diverse Society*. 2nd edition. Los Angeles: California Association for Bilingual Education.

Çfarë avantazhesh ka dygjuhësia?

Disa nga avantazhet e dygjuhësisë dhe të arsimit dygjuhësh mund të jenë si më poshtë:



Avantazhe komunikimi

- Mundësi të gjera komunikimi (familje, komunitet, kontakte ndërkombëtare, punë)
- Shkrim e këndim në dy gjuhë

Avantazhe kulturore

- Ndërgjegje të gjerë e të thellë kulturore, identitet shumëkulturor, përvojë nga dy botë gjuhësore
- Më shumë tolerancë dhe më pak racizëm

Avantazhe dijesh

- Zhvillim të mendimit (p.sh. krijimtari, ndjeshmëri në komunikim)

Avantazhe të karakterit

- Vetvlerësim
- Siguri në ndjenjën e identitetit


Avantazhe shkollore

- Rezultate të larta
- Lehtësi në zotërimin e një gjuhe të tretë

Avantazhe ekonomike dhe profesionale

- Mundësi më të mëdha profesionale

Baker, C. (2000) *The care and education of young bilinguals*. Multilingual Matters. Chapter 2, p.12.



Nga fashikulli nr. 3 i revistës «Polidhromos» shtator 2010, fq. 93

Çfarë mund të bëni si prindër për të përforcuar dygjuhësinë e fëmijëve tuaj?



- Të jeni krenarë për trashëgiminë tuaj kulturore dhe për aftësinë tuaj të flisni në një gjuhë tjetër nga ajo greke. Të mbani mend se të gjithë ne përbëjmë një pjesë të shoqërisë ku jetojmë dhe nuk kemi pse të fshehim apo të ndihemi keq për origjinën tonë.
- Të lexoni libra dhe revista në gjuhën tuaj, të informoheni dhe të shoqëroheni me familje të tjera dygjuhëshe.
- Gjithashtu, përdorni ose krijoni libra dygjuhësh (në gjuhën tuaj dhe në greqisht). Gjatë kësaj përpjekjeje mund të bashkëpunoni me mësuesit e fëmijëve tuaj. Librat dygjuhësh shërbejnë si urë midis dy gjuhëve të fëmijës dhe ndihmojnë të kuptojë ngjashmëritë dhe ndryshimet që kanë gjuhët e tyre.
- Ndihmojnë fëmijët të kuptojnë se edhe gjuhët e tjera kanë të njëjtën vlerë dhe të njëjtat funksione me gjuhën e tyre.
- Përdoren si urë lidhëse e alfabetizimit me gjuhën që fëmija njih më mirë.
- Funksionojnë si një urë e rëndësishme midis prindërve dhe fëmijëve, midis familjes dhe shkollës.
- Japin mundësinë të theksohen dallimet dhe ngjashmëritë në alfabetin e gjuhëve, në përdorimin dhe në kuptimin e tyre.
- Nëse fëmija juaj i përzie të dyja gjuhët ose refuzon të flasë gjuhën tuaj, mos u dekurajoni.

Mos harroni se fëmijët ndryshojnë shumë ndërmjet tyre në zhvillimin e personalitetit dhe të nivelit gjuhësor. Si rrjedhim ju këshillojmë të mos alarmoheni nëse fëmija juaj nuk është zhvilluar akoma gjuhësisht si ndonjë tjetër bashkëmoshatar i tij/saj.

- Merrni parasysh se dygjuhësia, ashtu si në përgjithësi sjellja gjuhësore e fëmijëve, ndryshon gjatë jetës sonë. Sa më të qëndrueshëm jeni në përdorimin e gjuhës suaj dhe për sa kohë që fëmijët tuaj kanë nevojën t'a përdorin atë, aq më shumë do të zhvillohet dygjuhësia e tyre.
- **Mos harroni të jeni pozitivë ndaj dygjuhësisë, duke u kujtuar fëmijëve avantazhet e shumta të dygjuhësisë, por dhe nevojën për të komunikuar me familjen dhe të afërmit si dhe me komunitetin e tyre.**

